



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME  
“TEDATIRANË” SH.P.K.

V E N D I M

Nr. 2, datë 30/9 / 2024

PËR

“MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË NENIT 6, PIKA 3, TË STATUTIT TË  
SHOQËRISË “TEDA TIRANË” SH.P.K.

DHE

MIRATIMIN E PROPOZIMIT TË DHËNIES NË PËRDORIM PA  
KUNDËRSHPËRBLIM TË PRONËS ME NUMËR PASURIE 3/491 + 10-N4,  
REGJISTRUAR NË VOL. 59, FQ. 39, NDODHUR NË ZK. 8220”.

Në mbështetje të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar; Vendimit Nr. 169, datë 20.03.2024, të Këshillit të Ministrave “Për Miratimin e Kontratës, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Zhvilluesit, Bashkia Tiranë, për Ndërtimin, Administrimin dhe Monitorimin e Funkcionimit të Zonës së Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik në Tiranë (TEDA Tiranë)”; Vendimit Nr. 54, datë 30.05.2024, të Këshillit Bashkiak, “Për Krijimin e shoqërisë “TEDA Tiranë” sh.p.k., si person juridik në Pronësi të Bashkisë Tiranë dhe miratimin e Akteve të Themelimit”; Vendimit Nr. 76, datë 22.07.2024, të Këshillit Bashkiak, “Për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “TEDA Tiranë” sh.p.k., si person juridik në pronësi të Bashkisë Tiranë”; si dhe komunikimit shkresor nr. 4 Prot, datë 15.07.2024 të shoqërisë “TEDA Tiranë” sh.p.k.; komunikimit shkresor nr. 27300/1 prot., datë 05.08.2024, nga Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licensimit; komunikimit shkresor nr. 9/1 prot., datë 16.08.2024, të shoqërisë “TEDA Tiranë” sh.p.k. drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme Juridike të Aseteve dhe Licensimit; komunikimit shkresor nr.27300/3 prot., datë 26.09.2024;

Sot, më datë 30/09/2024, ora 12:00, u mbledh Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë “TEDA Tiranë” sh.p.k., me NIPT M41824035Q, pranë selisë së saj me adresë: Sheshi “Skënderbej”, Ndërtesa 2, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri, me prezencën e 100% të kuotave pjesëmarrëse, respektivisht të Z. Erion VELIAJ, në cilësinë e ortakut të vetëm themelues të shoqërisë “TEDA Tiranë” sh.p.k., me rendin e dîtës si më poshtë vijon:

Rendi i ditës:

1. Miratimin e ndryshimit të kapitalit të shoqërisë "TEDA Tiranë" sh.p.k., sipas VKB me Nr. 76, datë 22.07.2024, "Për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "TEDA Tiranë" sh.p.k., si person juridik në pronësi të Bashkisë Tiranë".
2. Miratimin e propozimit të dhënies në përdorim pa kundërshpërblim, të pronës me numër pasurie 3/491 + 10-N4, regjistruar ne Vol. 59, Fq. 39, ndodhur në zonën kadastrale 8220, shoqërisë "TEDA Tiranë" sh.p.k.

Mbledhjen e hapi administratori i shoqërisë Z. Dritan Delija, i cili bëri një prezantim mbi nevojën për sigurimin e ambjentit për zyra, që do të shërbejë për fillimin e ushtrimit të veprimtarisë të shoqërisë "TEDA Tiranë" sh.p.k., për të cilin parashikohet se Bashkia Tiranë do të sigurojë mbështetjen nga inventari i saj për mjediset e nevojshme, deri në përfundimin e ndërtimit të Zonës së Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik në Tiranë (TEDA TIRANË). Gjithashtu, në bazë të Vendimit Nr. 76 datë 22.07.2024, të Këshillit Bashkiak, "Për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "TEDA Tiranë" sh.p.k., si person juridik në pronësi të Bashkisë Tiranë", si dhe në vijim të veprimeve financiare nga organet përgjegjëse të Bashkisë Tiranë, Asambleja e Përgjithshme, mbledhur në sesion të vlefshëm, procedon me marrjen e vendimeve si më poshtë:

\*\*\*\*\*

Në lidhje me pikat e rendit të ditës, Ortaku i Vetëm **Vendosi**:

1. Miratimin e ndryshimit të kapitalit të shoqërisë "TEDA Tiranë" sh.p.k., nëpërmjet kontributit në para nga ortaku i vetëm themelues Bashkia Tiranë, miratuar në Vendimin Nr. 76, datë 22.07.2024, të Këshillit Bashkiak, "Për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "TEDA Tiranë" sh.p.k., si person juridik në pronësi të Bashkisë Tiranë", në shumën prej 20,000,000.00 (njëzet milionë) Lekë, duke e rritur kapitalin e kësaj shoqërie nga vlera fillestare prej 100 (njëqind) Lekë, në vlerën e përgjithshme **20,000,100 (njëzet milionë e njëqind) Lekë**. Në përputhje me parashikimin e Nenit 13 të Statutit të shoqërisë, Neni 6, paragrafi i tretë, ndryshon dhe bëhet si më poshtë vijon:

#### Neni 6

#### Kapitali i TEDA Tiranë

- Kapitali fillestar i investuar nga ortakët, përbën bazën e krijimit të fondit themeltar të mjeteve të xhiros. Administratori i dorëzon ortakëve dokumentin vërtetues për sasinë e shumave të derdhura në fazën e themelimit
- Kapitali themeltar i shoqërisë "TEDA Tiranë" sh.p.k. përbëhet nga kontributi në para nga Ortaku themelues.

- Kontributi në para do të ketë vlerën prej 20,000,100 (njëzet milionë e njëqind) Lekë, i ndarë në 1 (një) kuotë, e zotëruar nga Ortaku i vetëm.

2. Miratimin e propozimit të dhënies në përdorim pa kundërshpërblim, të pronës me numër pasurie 3/491 + 10-N4, regjistruar ne Vol. 59, Fq. 39, ndodhur në zonën kadastrale 8220, shoqërisë "TEDA Tiranë" sh.p.k.
3. Ngarkohet Administratori i Shoqërisë për ndjekjen e procedurave të regjistrimit të ndryshimit të kapitalit në Qendrën Kombëtare të Biznesit, si dhe organet kompetente të aparatit të Bashkisë Tiranë, për ndjekjen e procedurave të parashikuara ligjore, lidhur pronën e sipërpërmendur.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

ORTAKU THEMELUES:

BASHKIA TIRANË

Përfaqësuar nga:

KRYETARI

ERION VELIAJ

